

Pyetjet më të shpeshta për zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it dhe ndihmës ekonomike.

Nëse përfitimet e SNAP-it ose ndihmës ekonomike ju janë vjedhur në rrugë elektronike, tani mundeni që të paraqisni një kërkesë për zëvendësimin e këtyre përfitimeve të vjedhura. Përfitimet tuaja mund të zëvendësohen pjesërisht ose plotësisht.

Shënim: Autoritetit federal që mundëson zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it i përfundon mandati më 30 shtator 2024. DSS-ja nuk mund të lëshojë zëvendësimin e përfitimeve të vjedhura të SNAP-it nëse ndodhin pas datës 30 shtator 2024. Ju mund të bëni përsëri kërkesë për zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it pas datës 30 shtator, me kusht që vjedhja të ketë ndodhur në datën ose para datës 30 shtator, dhe që kërkesa të jetë bërë brenda 30 ditësh nga momenti kur keni mësuar se përfitimet janë vjedhur. Kjo nuk ndikon te kërkesat për përfitimet e kopjuara të ndihmës ekonomike.

Çfarë është vjedhja elektronike e përfitimeve (e njohur gjithashtu si “kopjimi” (“skimming”), “peshkimi elektronik” (“phishing”) ose “klonimi i kartës” (“card cloning”))?

Kopjimi është një formë vjedhjeje. Hajdutët vendosin një shtresë në aparatin e leximit të kartave që përdoren në dyqane, për të kopjuar informacionin e kartës EBT, kartës së kreditit dhe debitit. Hajdutët e përdorin informacionin për të prodhuar karta të rreme (të quajtura “klone”) dhe i përdorin ato për të vjedhur para nga llogaritë. Kopjimi mund të ndodhë kudo që ju kaloni kartën tuaj të EBT-së. Përfitimet tuaja mund të vidhen përmes kopjimit edhe nëse ju e keni gjithmonë me vete kartën tuaj EBT.

Peshkimi elektronik është një skemë tjetër ku hajdutët i mashtrojnë njerëzit që të klikojnë në një link (zakonisht të dërguar me anë të mesazhit ose emailit) që i lejon ata të kenë qasje në informacionin e llogarisë tuaj.

Çfarë duhet të bëj nëse përfitimet e mia janë vjedhur?

Mund të përjetoni acarim dhe frikë nëse ju vjedhin përfitimet. Por ka hapa që mund të ndiqni për të reduktuar rrezikun dhe të dërgoni një kërkesë për përfitime zëvendësuese.


Hapi 1. Raportoni kartën tuaj si të vjedhur. Nëse vini re që përfitimet tuaja janë vjedhur, duhet ta raportoni kartën tuaj EBT si të vjedhur. Për të raportuar vjedhjen e kartës tuaj, për të kërkuar një kartë të re dhe për të ndryshuar kodin PIN, shkoni te <https://www.ebtedge.com/> ose telefononi Shërbimin ndaj Klientit të EBT-së në numrin 888-328-6399. Ju nuk do të merrni asnjë përfitim zëvendësues nëse nuk e keni raportuar kartën tuaj të EBT-së si të vjedhur. **Shënim:** për momentin, faqja ebtedge.com është e disponueshme vetëm në anglisht. Linja e Shërbimit ndaj Klientit të EBT-së ju kërkon të vendosni katër shifrat e fundit të numrit të kartës suaj EBT. Pas kësaj, shërbimi bëhet i disponueshëm në gjuhën arabe, mandarine, angleze, kreole të Haitit, italiane, koreane, ruse dhe spanjolle.

Hapi 2. Merrni historikun e transaksioneve të EBT-së. Për të paraqitur një kërkesë për përfitime zëvendësuese, ju duhet të raportoni datën, vendndodhjen dhe shumën e çdo transaksioni individual të paautorizuar. Këto janë transaksione që nuk janë bërë nga ju, por nga personi që ka vjedhur informacionin e kartës suaj.

Si të merrni historikun e transaksioneve të EBT-së:

Ka disa mënyra për të marrë historikun e transaksioneve të EBT-së. Zgjidhni atë që është më i lehtë për ju:

- **Opsioni 1:** Duke kontrolluar historikun e EBT-së në adresën ebtedge.com/ ose duke shkarkuar aplikacionin celular ebtEDGE (mund të shkarkohet në Apple App Store dhe Google Play Store); ose
- **Opsioni 2:** Duke telefonuar linjën pa pagesë të Shërbimit të Klientit të EBT-së në numrin 1-888-328-6399. Ju mund ta përdorni linjën e ndihmës për të dëgjuar dhjetë transaksionet tuaja të fundit në menynë e automatizuar ose të kërkonti një deklaratë të printuar dymujore të historikut të llogarisë suaj nga menyja e automatizuar ose nga një përfaqësues i shërbimit të klientit. Gjithashtu, ju mund t'i rishikoni transaksionet tuaja me një përfaqësues të shërbimit të klientit. Për transaksionet më të hershme se 15 muaj më parë, do t'ju duhet të flisni me një përfaqësues.



Historiku i EBT-së do të përfshijë kryesisht transaksione që mbani mend, si për shembull blerjet në dyqanin ushqimor ku shkoni zakonisht. Por mund të shikoni edhe transaksione që duken të çuditshme, si për shembull blerje në dyqane ku nuk keni blerë kurrë, ndoshta edhe në qytete ku nuk keni qenë kurrë. Këto lloj transaksionesh mund të tregojnë se është kryer një vjedhje elektronike e përfitimeve (mashtrim). Ju duhet të raportoni datën, vendndodhjen dhe shumën e transaksioneve të paautorizuara për të paraqitur një kërkesë për përfitime zëvendësuese.

Hapi 3. Dërgoni një kërkesë për përfitime zëvendësuese.

Pasi të keni identifikuar transaksionet e paautorizuara, jeni gati për të dërguar një kërkesë për përfitime zëvendësuese.

Ka disa mënyra për të dërguar një kërkesë:

1. Në internet: vizitoni nyc.gov/hra

Dërgimi i një kërkesë **në internet është metoda më e shpejtë dhe e lehtë! DSS-ja u rekomandon aplikuesve që të dërgojnë një kërkesë në internet nëse është e mundur.**

2. Me postë: Për të marrë një formular kërkesë në letër, mund të:

- printoni formularin e kërkesës që gjeni në nyc.gov/hra ose
- telefononi numrin e informimit [718-557-1399] dhe të kërkonti që t'ju dërgohet një formular me postë.
- Vizitoni qendrën tuaj lokale

Formularin e plotësuar të kërkesës mund ta dërgoni me postë në adresën:

Departamenti i Shërbimeve Sociale
P.O. Box 02-9121
Brooklyn GPO, Brooklyn, NY 11202

Dërgimi i formularit të kërkesës, veçanërisht të kërkesës për dërgimin e formularit me postë, është metoda më e ngadaltë dhe mund të duhet më shumë kohë që DSS-ja të marrë kërkesën tuaj dhe të lëshojë përfitimet zëvendësuese.

3. Personalisht: Mund ta vizitoni Qendrën për qasje në Përfitime, Qendrën SNAP, ose Qendrën HASA. Mund t'i gjeni qendrat e SNAP-it dhe BAC-së në adresën nyc.gov/hra (nën skedën “Vendndodhjet”).

Çfarë informacioni do të më duhet për të paraqitur një kërkesë?

Do t’ju duhet:

1. Numri i identifikimit të klientit (CIN) dhe numri i çështjes.
2. Adresa aktuale postare
3. Data, vendndodhja dhe shuma e çdo transaksioni të paautorizuar.

Nëse ju kanë vjedhur përfitimet e SNAP-it dhe ndihmës ekonomike, ju duhet t’i raportoni ato në të njëjtin formular kërkesë. Do të ketë seksione të veçanta në formular, kështu që transaksionet nuk do të ngatërrohen.

Çfarë është numri i identifikimit të klientit (CIN)?

Numri i identifikimit të klientit është një kod 8-shifror, i cili përbëhet nga një kombinim germash dhe numrash. Ju mund të gjeni numrin tuaj të identifikimit të klientit në kartën tuaj EBT, si më poshtë. Ai është i etiketuar si “ID Number” (Numri i ID-së). Çdo person në një çështje ka numrin e tij CIN, por ju duhet të përdorni numrin CIN të listuar në kartën tuaj EBT në mënyrë që aplikimi të përpunohet, edhe nëse ai numër CIN i përket dikujt tjetër në çështjen tuaj.

Numri i identifikimit të klientit (CIN) është i shënuar këtu. Ai është i etiketuar si “ID NUMBER”.



Si mund ta gjej numrin tim të çështjes?

Numri juaj i çështjes ka dhjetë karaktere. Nëntë karakteret e para janë numra dhe karakteri i fundit është një gërmë. Numri juaj i çështjes nuk është i shënuar në kartën tuaj EBT, por ju mund ta gjeni atë në çdo njoftim që HRA-ja ju ka dërguar në lidhje me çështjen tuaj, si dhe duke hyrë në portalin ACCESSHRA. Nëse keni probleme me gjetjen e numrit të çështjes, mund të telefononi edhe linjën e informimit [718-557-1399] ose të vizitoni qendrën tuaj.

Pse duhet të konfirmoj se e kam raportuar kartën time si të humbur ose të vjedhur?

HRA-ja dëshiron të sigurohet që llogaria juaj nuk është më në rrezik dhe se përfitimet zëvendësuese që do të shtohen në kartën tonë nuk do të vidhen sërish. Udhëzimet e mësipërme dhe udhëzimet në formularin e kërkesës mund t'ju udhëzojnë gjatë procesit të raportimit të vjedhjes së kartës.

Si mund ta plotësoj pjesën e mbetur të formularit të kërkesës?

Përpara se të listoni transaksionet tuaja individuale të vjedhura, ju duhet të plotësoni disa fusha përmbledhëse.

Përfitimet nga ndihma ekonomike: Seksioni i parë ka të bëjë me përfitimet e vjedhura nga ndihma ekonomike. Në rast se përfitimet tuaja nga ndihma ekonomike nuk janë vjedhur, ju lutemi ta lini këtë seksion bosh. Më poshtë është një listë e pyetjeve dhe udhëzimeve.

- **Data kur konstatova që përfitimet e mia nga ndihma ekonomike ishin vjedhur:** Kjo është data në të cilën kuptuat se ju kanë vjedhur përfitimet tuaja. Kjo mund të mos jetë data kur është kryer vjedhja. Kjo datë nuk duhet të jetë *para* datës së transaksioneve të paautorizuara. **Nëse nuk e dini datën e saktë, duhet ta lini bosh këtë fushë.** Kërkesa juaj nuk do të refuzohet nëse e lini bosh këtë fushë.
- **Data e parë kur janë vjedhur përfitimet nga ndihma ekonomike:** Kjo është data më e hershme në historikun tuaj të transaksioneve kur shihni një transaksion të paautorizuar. Për shembull, nëse shihni transaksione të paautorizuara të ndihmës ekonomike më datë 3 prill 2023 dhe 4 prill 2023, atëherë këtu duhet të shënoni datën 3 prill 2023. Nëse shihni transaksione të paautorizuara vetëm në një datë, vendoseni atë datë këtu. Kini parasysh se transaksionet e ndihmës ekonomike përpara datës 1 janar 2022 nuk kualifikohen për zëvendësim dhe për rrjedhojë nuk duhet të listohen.
- **Data e fundit kur janë vjedhur përfitimet nga ndihma ekonomike:** Kjo është data më e fundit në historikun tuaj të transaksioneve kur shihni një transaksion të paautorizuar. Për shembull, nëse shihni transaksione të paautorizuara të ndihmës ekonomike më datë 5 maj 2023 dhe 6 maj 2023, atëherë këtu duhet të shënoni datën 6 maj 2023. Nëse shihni transaksione të paautorizuara vetëm në një datë, vendoseni atë datë këtu. Nëse shihni transaksione të paautorizuara vetëm në një datë, "data e parë" dhe "data e fundit" do të jenë të njëjta dhe kjo gjë nuk përbën problem.

- **Totali i përfitimeve të vjedhura nga ndihma ekonomike:** Kjo është shuma totale e parave të vjedhura nga përfitimet e ndihmës ekonomike. Kjo duhet të jetë shuma (totale) e transaksioneve të paautorizuara të ndihmës ekonomike. Për shembull, nëse raportoni një transaksion të paautorizuar të ndihmës ekonomike prej \$300 dhe një transaksion tjetër të paautorizuar të ndihmës ekonomike prej \$200, atëherë totali i listuar këtu duhet të jetë \$500. Është shumë e rëndësishme që ta plotësoni saktë fushën “Totali”.

Përfitimet nga programi SNAP: Seksioni tjetër kërkon informacion rreth përfitimeve nga programi SNAP. Në rast se përfitimet tuaja nga programi SNAP nuk janë vjedhur, ju lutemi ta lini këtë seksion bosh. Udhëzimet këtu janë identike me ato të seksionit të mësipërm për ndihmën ekonomike, por janë për programin SNAP në vend të ndihmës ekonomike.

- **Data kur konstatova që përfitimet e mia nga programi SNAP ishin vjedhur:** Kjo është data në të cilën kuptuat se ju kanë vjedhur përfitimet tuaja nga programi SNAP. Kjo mund të mos jetë data kur është kryer vjedhja. Kjo datë nuk duhet të jetë *para* datës së transaksioneve të paautorizuara të programit SNAP. **Nëse nuk e dini datën e saktë, mund ta lini bosh këtë fushë.** Kërkesa juaj nuk do të refuzohet nëse e lini bosh këtë fushë.
- **Data e parë kur janë vjedhur përfitimet nga programi SNAP:** Kjo është data më e hershme në historikun tuaj të transaksioneve kur shihni një transaksion të paautorizuar të programit SNAP. Për shembull, nëse shihni transaksione të paautorizuara të SNAP-it më datë 3 prill 2023 dhe 4 prill 2023, atëherë këtu duhet të shënoni datën 3 prill 2023. Nëse shihni vetëm transaksione të paautorizuara të programit SNAP në vetëm një datë, renditeni atë datë këtu. Kini parasysh se transaksionet e programit SNAP përpara datës 1 tetor 2022 nuk kualifikohen për zëvendësim, dhe për rrjedhojë nuk duhet të listohen. Siç është përmendur më sipër, DSS-ja nuk mund të lëshojë zëvendësimin e përfitimeve të vjedhura të SNAP-it nëse ndodhin pas datës 30 shtator 2024. Ju mund të bëni përsëri kërkesë për zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it pas datës 30 shtator, me kusht që vjedhja të ketë ndodhur në datën ose para datës 30 shtator, dhe që kërkesa të jetë bërë brenda 30 ditësh nga momenti kur keni mësuar se përfitimet janë vjedhur.
- **Data e fundit kur janë vjedhur përfitimet nga programi SNAP:** Kjo është data më e *fundit* në historikun tuaj të transaksioneve kur shihni një transaksion të paautorizuar të programit SNAP. Për shembull, nëse shihni transaksione të paautorizuara të SNAP-it më datë 5 maj 2023 dhe 6 maj 2023, atëherë këtu duhet të shënoni datën 6 maj 2023. Nëse shihni transaksione të paautorizuara të programit SNAP vetëm në një datë, vendoseni atë datë këtu. Nëse shihni transaksione të paautorizuara vetëm në një datë, “data e parë” dhe “data e fundit” do të jenë të njëjta dhe kjo gjë nuk përbën problem. **Megjithatë, vetëm përfitimet SNAP që janë vjedhur para datës 30 shtator 2024 do të kualifikohen për zëvendësim.**

- **Totali i përfitimeve të vjedhura nga programi SNAP:** Kjo është shuma totale e parave të vjedhura nga përfitimet e ndihmës SNAP. Kjo duhet të jetë shuma (totale) e transaksioneve të paautorizuara të ndihmës SNAP. Për shembull, nëse po raportoni një transaksion të paautorizuar të programit SNAP prej \$400 dhe një transaksion tjetër të paautorizuar të programit SNAP prej \$300, atëherë totali i listuar këtu duhet të jetë \$700. Është shumë e rëndësishme që ta plotësoni saktë fushën "Totali".

Shënim: Ju nuk duhet t'i mblihdni përfitimet nga programi SNAP dhe ndihmat ekonomike në një "TOTAL". Për shembull, nëse ju kanë vjedhur përfitime prej \$400 nga ndihma ekonomike dhe përfitime prej \$500 nga programi SNAP, "TOTALI" juaj duhet të jetë \$400 në seksionin e ndihmës ekonomike dhe \$500 në seksionin e programit SNAP - jo \$900 në secilin seksion.

A duhet ta plotësoj pjesën e vërtetimit në seksionin e fundit?

Po – Kërkesa juaj nuk do të pranohet nëse nuk zgjidhni kutinë që vërteton saktësinë dhe vërtetësinë e kërkesës tuaj.

Çfarë ndodh nëse çështja ime është mbyllur?

Nuk është e nevojshme të keni një çështje aktive për SNAP-in ose ndihmën ekonomike që të jeni të kualifikueshëm për të marrë një përfitim zëvendësues. Nëse është vërtetuar që përfitimet tuaja janë vjedhur në mënyrë elektronike, si për shembull përmes kopjimit të kartës EBT, klonimit të saj, keqinterpretimit nga palët e treta, ose metodave të tjera të ngjashme të mashtrimit si peshkimi elektronik, ju mund të jeni të kualifikueshëm për përfitimet zëvendësuese edhe nëse çështja juaj është mbyllur. Nëse jeni të kualifikueshëm për përfitimet zëvendësuese, ato do të jenë të disponueshme për t'u përdorur në kartën tuaj EBT edhe nëse çështja juaj është e mbyllur. Nuk është e nevojshme të aplikoni përsëri për SNAP ose ndihmë ekonomike në mënyrë që të keni qasje në përfitimin zëvendësues.

A do të zëvendësohet e gjithë shuma e përfitimit të vjedhur?

Varet. Për të dyja llojet e përfitimit, përfitimi zëvendësues që kualifikoheni për të marrë është shuma e përfitimeve të SNAP-it ose e ndihmës ekonomike që është vjedhur, ose një shumë e barabartë me dyfishin (2) e përfitimeve të SNAP-it ose të ndihmës ekonomike që keni marrë në muajin më të fundit të plotë, gjatë të cilit keni marrë SNAP ose ndihmë ekonomike para se përfitimet tuaja të vidheshin, **cilado të jetë shuma më e vogël.**

Sa kohë do më duhet që të marr përfitimet pasi të dërgoj një kërkesë?

Koha e përpunimit është e ndryshme. Nëse jeni pranuar për përfitime zëvendësuese, prisni deri në 4 javë që përfitimet zëvendësuese të hidhen në kartën tuaj dhe për të marrë një njoftim me postë që ju informon për vendimin tonë. Nuk është e nevojshme të dërgoni një kërkesë tjetër ndërkohë që kërkesa po përpunohet; dërgesa e një kërkesë tjetër nuk do na ndihmojë ta përpunojmë kërkesën tuaj më shpejt.

Sa kohë kam për të dërguar një kërkesë për përfitime zëvendësuese pasi kam zbuluar vjedhjen?

Si për SNAP-in, edhe për ndihmën ekonomike, ju duhet të dërgoni një kërkesë për përfitime zëvendësuese brenda 30 ditësh nga momenti që keni zbuluar vjedhjen e përfitimeve tuaja. Kjo do të thotë se nëse "data e zbulimit" që vendosni në kërkesën tuaj është më e hershme se para 30 ditësh,

kërkesa juaj do të refuzohet. Megjithatë, nëse nuk e dini datën e saktë, mund ta lini bosh këtë fushë. Kërkesa juaj nuk do të refuzohet nëse e lini bosh këtë fushë.

Shënim: Autoritetit federal që mundëson zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it i përfundon mandati më 30 shtator 2024. DSS-ja nuk mund të lëshojë zëvendësimin e përfitimeve të vjedhura të SNAP-it nëse ndodhin pas datës 30 shtator 2024. Ju mund të bëni përsëri kërkesë për zëvendësimin e përfitimeve të kopjuara të SNAP-it pas datës 30 shtator, me kusht që vjedhja të ketë ndodhur në datën ose para datës 30 shtator, dhe që kërkesa të jetë bërë brenda 30 ditësh nga momenti kur keni mësuar se përfitimet janë vjedhur. Kjo nuk ndikon te kërkesat për përfitimet e kopjuara të ndihmës ekonomike.

Ka një përjashtim për rregullin e 30 ditëshit: raportimi i transaksioneve të paautorizuara para datës 21 gusht 2023. Për kërkesat me efekt prapaveprues të SNAP-it me data vjedhjeje nga 1 tetori 2022 dhe kërkesat ,e efekt prapaveprues të ndihmës ekonomike me data vjedhjeje nga 1 janari 2022 deri në 21 gusht 2023, familjet duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë aplikimin e zëvendësimit pranë distriktit brenda 31 dhjetorit 2023, ose brenda tridhjetë (30) ditësh nga data kur është zbuluar vjedhja, cilado qoftë data më e vonë.

Sa të vjetra mund të jenë vjedhjet e përfitimeve që raportojmë?

Ka rregulla të veçanta për ndihmën ekonomike dhe SNAP-in.

Për ndihmën ekonomike: zëvendësimi i përfitimeve të ndihmës ekonomike është i kufizuar për transaksionet e paautorizuara në datën ose pas datës **1 janar 2022**.

Për SNAP-in: zëvendësimi i përfitimeve të SNAP-it është i kufizuar për transaksionet e paautorizuara në datën ose pas datës **1 tetor 2022 dhe deri më 30 shtator 2024**. Transaksionet e paautorizuara të SNAP-it pas 30 shtatorit 2024 nuk janë të kualifikueshme për zëvendësim.

Po nëse përfitimet e mia janë vjedhur më shumë se një herë? A ka limit për numrin e herëve që mund të dërgoj një kërkesë?

Ka rregulla të veçanta për ndihmën ekonomike dhe SNAP-in.

Për ndihmën ekonomike: Familjet nuk mund të marrin më shumë se dy (2) zëvendësime për ndihmën ekonomike për periudhën nga 1 janari 2022 deri në 30 shtator 2022. Prandaj, familjet nuk mund të marrin më shumë se dy (2) zëvendësime për përfitimet nga ndihma ekonomike në një vit të plotë tatimor federal (1 tetor 2022 deri më 30 shtator 2023, dhe 1 tetor 2023 deri më 30 shtator 2024). Pas datës 30 shtator 2024, familjet janë të kualifikueshme për të marrë vetëm një (1) përfitim zëvendësues nga ndihma ekonomike në një vit të plotë tatimor federal.

Për SNAP: Familjet nuk mund të marrin më shumë se dy (2) zëvendësime për përfitimet e SNAP-it në një vit të plotë tatimor federal (1 tetor 2022 deri më 30 shtator 2023, dhe 1 tetor 2023 deri më 30 shtator 2024).